



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2018, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Shqyrtimi i projektligjit “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”
(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Florjon Mima, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Robert Bitri, Gjetan Gjetani, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Besnik Baraj, Eglantina Gjermani, Lorenc Luka, Hekuran Hoxhalli, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Dritan Bici, Lefter Koka dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Majlinda Hafizi – Drejtoreshë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Anduena Hoxha – përgjegjëse sektori, Ministria e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përsëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Siç ju kemi vënë në dijeni, ditën e sotme do të shqyrtojmë në komision projektligjin “Për denoncimin e marrëveshjes ndërkombëtare, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”, ratifikuar me ligjin nr.86/2015”.

Data e shqyrtimit në seancë parlamentare është 23 korrik.

Të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi znj. Majlinda Hafizi dhe znj. Anduena Hoxha. Ju urojmë mirëseardhjen në komision!

Relator i projektligjit është z. Rrahman Rraja.

Fillimisht do të dëgjojmë përfaqësuesit e ardhur në komision. Më pas do të vazhdojmë me pyetjet, përgjigjet për to dhe në fund me komente dhe diskutime nga anëtarët e komisionit.

Jeni dakord me rendin e ditës?

Ilir Beqaj – Janë dy projektligje, për të cilat thoni se bankat kanë para, por ne nuk i përdorim dot ato.

Majlinda Hafizi – Është e thjeshtë. Duke qenë se dakordësimi i palëve është bërë që më vitin 2010 dhe brenda vitit fondet digjen, pala gjermane na nxiti t'i denoncojmë këto marrëveshje. Pra, marrëveshja që nga miratimi i saj nuk është bërë asnjëherë aktive dhe për këtë arsye është propozuar nga pala gjermane një projekt marrëveshje e re për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive”, duke vënë në dispozicion një shumë financimi në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) euro, duke mbështetur dhe promovuar ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale.

Projektligji ka si qëllim shfuqizimin dhe denoncimin e marrëveshjes së nënshkruar në datën 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, të miratuar me ligjin nr.86/2015, për projektin “Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale, faza e dytë”.

Marrëveshja do të funksiononte nëpërmjet bankave të nivelit të dytë dhe do të monitorohej nga KfW-ja, e cila gjatë periudhës shtator 2015-2016 ka kontaktuar periodikisht bankat e nivelit të dytë për të mundësuar bërjen efektive të linjës së kredisë, por pa sukses,

për shkak të mungesës së garancive nga ana e kredimarrësve, pra SME-ve, që duhet të vendosnin pranë këtyre bankave.

Në kuadër të bashkëpunimit financiar qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë përmes bankës gjermane për rindërtim KfW, do të vërë në dispozicion një shumë financimi në vlerën 5 000 000 (pesë milionë) euro, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes Fondit të Garancisë së Kredive Rurale (RCGF)”, por realizimi i këtij projekti kushtëzohet nga lidhja e një marrëveshjeje të re mes dy qeverive.

Për t’i bërë këto fonde të disponueshme Republika Federale e Gjermanisë ka propozuar anulimin me dakordësi të ndërsjellë të marrëveshjes së nënshkruar në datën 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2010, të miratuar me ligjin nr.86/2015.

Eduard Shalsi – Ka pyetje?

A jemi gati për votim?

Hapim votimin për miratimin në parim.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 1?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

MBYLLET MBLEDHJA